



Komuna e Lipjanit

KONTRATA PËR SHËRBIME

E lidhur në Lipjan më 30/11/2018 ndërmjet palëve:

Komuna e Lipjanit përfaqësuar nga drejtori i prokurimit z.Adem Duriqi në vazhdim (permendet) Autoriteti kontraktues dhe

“UNI SELLER” SH.P.K. rr. Martirët e Lipjanit-Lipjani përfaqësuar nga Petrit Rizani vazhdim do të përdoret (“Ofruesit te Shërbimeve”), nga ana tjetër:

Akomodimi dhe fjetja per 30 persona në Prevallë me numër Identifikues 613 018 107 236

Neni 1

Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë Hoteli duhet t'i kete rezervuar 30 dhoma gjumi per 2 net(ushqim dhe pije me tri racione),prej dates 30.11.2018 deri më 02.12.2018,sallen e ushqimit qe te mund te sherbehen me ushqim ne te njejten kohe te gjith klientet,si dhe sallën e konferencave.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrim të kontratës nga të dy palët dhe përfundon me kthimin e personave,gjegjesishte me (02.12.2018)

1.3 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë hoteli i cili duhet të ketë selinë në pushimoren në Prevallë

Neni 2

Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3

Çmimi

3.1 Çmimi i përgjithshëm i kontratës për kryerjen e shërbimeve nga neni1.1 shprehur me shifra është: 4260.00 €; apo shprehur me fjalë :katërmijë e dyqind e gjashtedhjetë euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër është e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit .

Neni 4

Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimi të tërë dërgesës, pas marrjes së shërbimeve hoteliere dhe raportit të menaxherit të kontratës]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit, kontraktuesi do të ofrojë ushqimin në bazë të standardeve si nga cilësia dhe sasia të cilën e ka ofruar me rastin e ofertimit, të ofrojë komoditet për gjumë të rehatshëm për rezidentët e shtëpisë së komunitetit në Lipjan si dhe për përcjellësit e tyre

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, cilësinë dhe sasinë e shërbimeve të kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik 1 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumë që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *Gjykatën Themelore në Lipjan* në pajtim me ligjin e Kosovës.




Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqipe* në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Adem Duriqi	Emri:	Petrit Rizani
Pozita:	Drejtor i drejtorisë, prokurimit	Pozita:	drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	30.11.2018	Data:	30.11.2018
Vula:		Vula:	

Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Nr. i Artikullit.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për një natë	ÇMIMI PËR 2 NETË	SHUMA NË €
1.	REZERVIMI i 30 dhomave të gjumi për 2 net, për 30 persona	Dhoma gjumi	30	35.00	70.00	2100.00
Totali i Përgjithshëm:						2100.00

Tabela2

Nr. i Artikullit.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për një racion	SHUMA NË €
1.	Sigurimi i mëngjesit 3 ditë 30 persona	racion	90	8.00	720.00
2	Sigurimi i drekës për 3 ditë 30 persona	racion	90	8.00	720.00
3	Sigurimi i darkës për 3 ditë 30 persona	racion	90	8.00	720.00
	Shuma e përgjithshme			24.00	2160.00
	Shuma e përgjithshme tabela 1+2				4260.00